



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.259/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.259/2025 e datës 29.01.2025
- II. Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6.000.00 (gjashtëmijë) euro.
- III. Detyrohet Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 29.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 28 janar 2025, mbështetësja e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), aktualisht Kryetare e Autotitetit të Konkurrencës, znj.Neime Binaku Isufi, ka publikuar një video nga tubimi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, të mbajtur në Komunën e Suharekës më datë 28 janar 2025, në ora 18:00/h. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës ka theksuar se në këtë rast, subjekti politik LVV, gjatë fushatës zgjedhore ka përfituar nga nën punësi publik duke përdorur pozitën publike të saj, për të zhvilluar fushatën zgjedhore të këtij subjekti politik.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim, janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar të përcaktuar në nenin 36, paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP që të nxjerrë vendim me të cilin do të aprovojë si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik LVV, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptojë dënim me gjobë.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin e shpërndarë në story në rrjetin social me fotografi.

Më datë 30.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 31.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 31.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se ankesa është e pabazuar dhe e paqëndrueshme, kjo për faktin se e ankesa në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte veprimin e pretenduar si shkelje e cilado të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, par.1, nën par.1.11, me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur neni 36 par.2 i LZP-së. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se nga leximi i kësaj dispozite, vërehet qartë se subjekti politik LVV nuk ka inkurajuar ose përfituar nga nën punësi publik, duke përdorur pozitën e saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik, kjo për faktin se LVV në asnjë moment nuk ka qenë aktive (nuk ka përfituar) nga shpërndarja në rrjetet sociale të personit në fjalë. Për më tepër, Ligji për Zyrtarët Publik neni 25 parasheh të drejtat politike të zyrtarëve publik, brenda së cilave inkorporohet edhe veprimi i zyrtares Isufi. Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP, që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e palës palës parashtruese, kundër Lëvizjes Vetëvendosje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale ka vërtetuar se është publikuar në story në rrjetin social nga ana e Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, Neime Binaku Isufi dhe ka shpërndarë një video nga tubimi zgjedhor të mbajtur të subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, andaj nga provat e ofruara është vërtetuar se postimi i publikuar nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës është publikuar në story në rrjetin e saj social i cili postim kishte qenë aktiv 24 orë pas publikimit.

Referuar nenit 25 paragrafi 1. të Ligjit për Zyrtarët Publik me të cilin përcaktohet *“Zyrtarja/i publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik”*,

Sipas nenit 36 paragraf 2 te LZP ka parapare se: *Gjate periudhës se fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike te tij ose saj për te zhvilluar fushate për subjektin politik.*

Ndërsa sipas rregullës zgjedhore nr. 07/2024 nenit 5 paragraf 2 nën paragraf 2.1 është parapare se: Ne fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si ne vijim: te punësuarit ne institucionet shtetërore dhe publike, gjate orarit te rregullt te punës, përveç kandidateve te certifikuar, te cilët pezullojnë vendin e punës,

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 01.02.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara.

Paneli ka vërtetuar se nuk është kontestuese se Neime Binaku Isufi është kryetare e Autoritetit të Konkurences, po ashtu është vërtetuar se subjekti politik LVV me date 28 janar 2025 ne ora 18:00 ka mbajtur tubim elektoral ne Suhareke, dhe se e lartcekura ka qene pjese e atij tubimi pasi qe ne story kishte shpërndarë nje foto nga takimi i mbajtur. Paneli vlerësoi se edhe pse takimi është mbajtur pas orarit te rregullt te punës konkludohet se e njëjta ka vepruar ne kundërshtim me LZP sepse me vet faktin se duke qene Neime Binaku Isufi ne je pozite te lart udhëheqëse, pjesëmarrja ne një tubim politik gjate fushatës zgjedhore konsiderohet se e ka përdorë pozitën e saj për te zhvilluar fushate për subjektin politik, qe ne rastin konkret eshte subjekti LVV

Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se Kryetarja e Autotritetit të Konkurrencës, ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura sepse edhe përkundër pozitës aktuale qe mbanë është perfsire ne fushate zgjedhore.

Andaj Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se e njëjta ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, dhe se i njëjti nuk e ka inkurajuar ose përfitur nga nënpunësi publik dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.259/2025 më datën 01.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.